




REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / ANTI-CORRUPTION AGENCY	
D. D. D. / 2-D/DPK	Nr Prot. / Br Prot. / Prot No 01-524/2013
Nr. / 02	Data / Datum / Date 20.02-2013
PRISTINE	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë **04.04.2012**, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-4770/11, për z. *Sylë Hoxha* – U.D. Kryeprokuror i Prokurorisë së Qarkut në Prizren, për shkak se është shmangur situata me konflikt interesi në të cilën ndodhej ky Zyrtar i lartë publik.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

**I. Rastin nr. AKK-03-4770/11 është hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në ushtrimin e funksionit publik, për Zyrtarin e lartë, *Sylë Hoxha* – U.D. Kryeprokuror i Prokurorisë së Qarkut në Prizren. Lidhur me këtë rast, janë ndërmarrë veprimet e nevojshme sipas procedurës së paraparë ligjore për këtë situatë (Ligji Nr.04/L-051, Neni 18, pika 1).**

Nga informacionet e marra nga Agjensioni për regjistrimin e bizneseve në Kosovë, për biznesin privat “Avokat *Sylë Hoxha*” (D.P. 03-4770/11) rasti është identifikuar me dyshimin e bazuar për ekzistimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, që shfaqej nga ushtrimi i dy funksioneve të papajtueshme, si U.D. i Kryeprokurorit të Prokurorisë së Qarkut në Prizren, në njëren anë, dhe si Avokat i Regjistruar në Odën e Avokatëve të Kosovës, në anën tjetër.

Për këtë Zyrtarit të lartë i është bërë shkresa e parë njoftuese nga Agjencia Kundër Korrupsionit – AKK, me datën 27.02.2012 (Neni 18, paragrafi 5, Ligjit Nr.04/L-051).

Kësaj shkresë Zyrtari i Lartë, i është përgjigjur me datën 05.03.2012 dhe në takim në zyret e Agjencisë kundër korrupsionit, ai ka njoftuar zyrtarët e Agjencisë se paraprakisht kishte bërë ç' regjistrimin e funksionit të tij të Avokatit nga regjistri i Odës së Avokatëve të Kosovës, me një Vendim nr.687-1/2010, vërtetimin për të cilin, të lëshuar nga Oda e Avokatëve të Kosovës, me datën 02.08.2011, e ka sjellë si informacion në Agjenci.

Kështu, me këto informacione zyrtare për funksionin e Avokatit, të lëshuara nga Oda e Avokatëve të Kosovës, kemi konstatuar se është shmangur situata konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, gjithnjë duke u bazuar në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Nr.04/L-051) .

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit

/ Hasan Preteni /

